

Deskriptorët e pasaportës për shumë specie

Deskriptorët e pasaportës, sipas numërtimit të tyre

00. Kodi i Inventarit Kombëtar (NICODE). Ky kod identifikon *Inventarin Kombëtar* të atij vendi që përgatit Inventarin Kombëtar. Bëhen dhe përjashtime të tilla si *NGB* (Banka Gjenetike Kombëtare), p.sh., *NLD*, me kusht që të bihet dakort me *EURISCO*. Në rastin tonë, Kodi i Inventarit Kombëtar është *ALB*.

0. Numri i përhershëm i identifikimit (PUID) që i jepet një aksesioni për të qenë i identifikueshëm në shkallë globale përfshirë edhe informacionin që e shoqëroh atë aksesion.

1. Kodi i institutit (INSTCODE). Është pranuar që çdo institucion ku mbahen aksesione të resurseve gjenetike të ketë një kod të veçantë. Ky kod shërben, jo vetëm për ta dalluar atë nga institucionet e tjerë, por edhe si referencë për çdo përdorues të resurseve gjenetike kudo në botë për ta identifikuar atë dhe për t'iu drejtuar atij për çfarëdo interesimi që mund të ketë. Këta kode janë të publikuara dhe të njohura për të gjithë. Ata nuk mund të ndryshohen e sajohen nga kushdo-qoftë. Kodi i institutit përbëhet nga tre germa që përfaqësojnë kodin e vendit ku ndodhet ai institut, dhe nga një numër me tre shifra, pa lënë hapësirë nga kodi i vendit, psh: *ALB026*.

2. Numri i aksesionit (ACCENUMB). Çdo aksesion në një bankë gjenetike duhet të ketë numrin e vetë unik të aksesionit i cili e dallon atë nga aksesioni e tjerë në atë bankë gjenetike. Në sistemin e numërtimit nuk duhet të përdoren informacione të tjerë si, p.sh., viti i depozitimit, kodi i bimës, sepse mund të sjellin ngatërresa më vonë. Nga shembujt e mësipërm mund të shikoni se **numri i aksesionit është një identifikues i vetëm (unik)**, i cili dallon një aksesion nga një tjetër. Për të mos ngatërruar numrat e aksesioneve me numra të tjerë i shtohet numrit të aksesionit **emri i bankës gjenetike** që rrjedh nga gerrat e para të tij (**acronym name**), pa lënë hapësirë midis tyre. Kështu, p.sh., emri i shkurtuar i bankës gjenetike institucionale Shqiptare është "**AGB**". Për rrjedhojë, aksesionet do numërtohen: *AGB0001*; *AGB0002*; *AGB0003*, e kështu me radhë.

Numri i aksesionit shënohet nga personi përgjegjës i bankës gjenetike kur një mostër pranohet në bankë. Sapo numri i jepet një aksesioni, ai nuk mund të përdoret për asnjë aksesion tjetër në koleksionin e asaj banke gjenetike. Edhe kur një aksesion humbet, numri i tij nuk përdoret për një aksesion tjetër.

3. Numri i koleksionimit (COLLNUMB). Numri i koleksionimit është numri origjinal i mostrës shënuar nga koleksionuesi ose grupi i koleksionuesëve. Ai përbëhet nga emri ose inicialet e koleksionuesit (koleksionuesve) dhe një numër progresiv, pa lënë hapësirë midis tyre, p.sh.: *MH;BG;FH01*, *MH;BG;FH02*, *BG;FH03*; etj. Kur koleksionimi bëhet nga një ekip me më shumë se një koleksionues, inicialet e koleksionuesve ndahen me pikëpresje (;) pa lënë hapësirë midis tyre, p.sh.: *AS;NF;AI001*, *AS;NF;AI002*, etj. Numri i koleksionimit është i rëndësishëm për identifikimin e dublikatave që mbahen në koleksione të ndryshme.

4. Kodi i institutit koleksionues (COLLCODE). Shënohet kodi i institutit që koleksionon mostrën, p.sh.: *ALB026*, etj. Për këtë qëllim përdoren vetëm kodet e instituteve që janë publikuar nga *FAO*. Në rastet kur koleksionimin e bën instituti që mban koleksionin, kodi i institutit koleksionues (*COLLCODE*) është i njëjtë me atë të institutit që mban koleksionin (*INSTCODE*).

4.1 Emri i institutit koleksionues (COLLNAME). Shënohet emri i plotë i institutit që koleksionon mostrën, p.sh.: **Banka Gjenetike e Shqipërisë**, Instituti i Kërkimeve për Ullirin dhe Agrumet Vlorë, etj. Ky deskriptor përdoret vetëm në ato raste kur nuk mund të përdoret kodi i institutit koleksionues (*COLLCODE*) **për shkak se nuk është i vlefshëm në kodin FAO**. Kur emri ka në përbërje shumë fjalë ose disa emërtime ato shënohen pa hapsirë, por të ndarë vetëm me pikëpresje.

4.1.1 Adresa e institutit koleksionues (COLLINSTADDRESS). Shënohet adresa e institutit që koleksionon mostrën. Ky deskriptor përdoret vetëm në ato raste kur nuk mund të përdoret kodi i institutit koleksionues (*COLLCODE*) **për shkak se nuk është i vlefshëm në kodin FAO**. Vlerat e shumta shënohen pa hapsirë, por të ndara vetëm me pikëpresje.

4.2 Identifikuesi i misionit koleksionues (COLLMISSID). Shënohet kodi i identifikimit të misionit të koleksionimit që përdoret nga instituti që koleksionon mostrën, (sipas pikës 4 ose 4.1), p.sh.: “TCP-ALB-3401_FAO”; “LoA/TF/W2A- PR-01/ALBANIA I2015/ AGDT”; “CIATFOR-052”; etj.

5. Gjinia (GENUS). Emri i gjinisë shkruhet në gjuhën latine me germën e parë të madhe, p.sh., *Triticum*, *Phaseolus*, *Solanum*, etj.

6. Specia (SPECIES). Në fushën e këtij deskriptori shkruhet në gjuhën latine pjesa e epitetit të veçantë të emrit shkencor të bimës, e gjitha me germa të

vogla. Lejohet dhe shkurtimi “sp”. Shembuj: *aestivum*, *durum*, *lycopersicum*, etj., ose *sp*.

7. Autori i species (SPAUTHOR). Shënohet autori i species, ashtu siç është në informacionin e ardhur nga dhuruesi i mostrës. P.sh.: *L.*; *L.em.* *Fiori et Paol*; *Host*; *Roth*; *Req. ex bertol.*; etj.

8. Nënspesia (SUBTAXA). Ky deskriptor përdoret për të ruajtur çdo identifikues taksonomik shtesë për aksesionin, regjistrimi bëhet në gjuhën latine. Përdoren dhe shkurtime, si: “subsp”–për “subspecies”, “convar” –për “convariety”, “var”–për “variety”, “f”–për “form”. Shembuj: *subsp. fuscum*, *subsp. vulgaris var. nanus*, *var. macedonicum*, etj.

9. Autori i nënspesies (SUBTAUTHOR). Shënohet autori i **subtaxa** në nivelin taxonomic më të hollësishëm. Shembuj: (*Waldst. et Kit.*)*Arc*, *Papag.*, (*Korn*)*Mansf.*, (*Alef*)*Mansf.*

10. Emri i zakonshëm i bimës (CROPNAME). Shënohet emri i bimës që përfaqësohet nga aksesioni aktual, sipas gjuhës së folur. Regjistrimi i emrit të bimës bëhet në gjuhën angleze: *malting barley*–për elbin e birrës (elbin distik), *wheat*–për grurin, etj

11. Emri i aksesionit (ACCENAME). Për aksesionin aktual shënohet ose emri që është regjistruar në informacionin që shoqëron mostrën, ose emri i dhënë zyrtarisht atij aksesioni. Shembuj: *Dajti*, *Agimi*, *Kallmet*, etj. Në rastet kur për një aksesion ka më shumë se dy emra, ata regjistrohen të ndarë nga një pikëpresje (;), por pa lënë hapësirë midis tyre, p.sh.: *Emma;Avlon*, etj.

12. Data e pranimit (ACQDATE). Në këtë fushë regjistrohet data në të cilën një aksesion i ri pranohet në bankën gjenetike. Data regjistrohet sipas formatit *VVVVMMDD (YYYYMMDD)*. Pra, në fillim shënohet viti i plotë (p.sh., *1975*), mandej, pa lënë hapësirë nga viti, shënohet muaji me dy shifra dhe data me dy shifra. Kur muaji dhe data është me nga një shifër (nga 1 deri në 9) shënohet një “0” përpara (p.sh., *19750602*), që do të thotë se aksesioni ka hyrë në datën 2 Qershor të vitit 1975. Në rastet kur të dhënat e muajit dhe/ose të datës mungojnë ato duhet të shënohen me nga dy vijëza lidhëse (--), p.sh., *197506--*, ose *1975----*.

13. Vendi i origjinës (ORIGCTY). Plotësohet me kodin e vendit ku është koleksionuar fillimisht mostra. Për këtë qëllim përdoren kodet nga Lista e

Kodeve të vendit të publikuara nga FAO (ISO 3166-1). Kështu, p.sh., Kodi i Shqipërisë është ALB, i Greqisë GRC, i Gjermanisë DEU, etj.

Shënim: Deskriptorët nga 14 deri te 16 përdoren vetëm kur mostra është e koleksionuar.

14. Vendndodhja e pikës së koleksionimit (COLLSITE). Vendndodhja nën nivelin e pikës së koleksionimit (vendi që përcakton se ku është koleksionuar aksesioni). Në këtë informacion mund të përfshihet largësia në kilometra si dhe orientimi gjeografik i pikës së koleksionimit nga qyteti apo fshati më i afërt me të, ose pika e referencës të hartës së shkallëzuar. Nëse pika e koleksionimit të mostrës është p.sh., Petrela, për përshkrimin e vendndodhjes përcaktohet saktësisht se ku është marrë mostra si: *3 km në jug të Petrelës të rrethit Tiranë apo në anën e majtë të rrugës Tiranë-Elbasan, 300 m nga Ura e Peshkatarit.* Informacioni shkruhet në gjuhën angleze (*3 km South of Petrela of Tirana district; on the right of the road Tirana-Elbasan, 300 m from Peshkatari bridge*).

15. Shënim: për deskriptorët “Gjerësia dhe gjatësia gjeografike e pikës së koleksionimit”, informacioni mund të shkruhet në njërin nga opsionet: në formatin dhjetor (decimal) të gradëve (DD = Decimal degrees), ose në formatin gradë-minuta-sekonda i njohur me simbolet: DMS = Degrees, Minutes, Seconds).

15.1 Gjerësia gjeografike e pikës së koleksionimit (DECLATITUDE).

Informacioni shkruhet në formati dhjetor të gradëve, me vlera pozitive mbi ekuator dhe negative nën ekuator. Vendi ynë ndodhet mbi ekuator, prandaj do të kemi, psh: 41.3802 për *413802N* të dhënë sipas formatit gradë-minuta-sekonda (shiko 15.2).

15.2 Gjerësia gjeografike e pikës së koleksionimit (LATITUDE).

Informacioni shkruhet në sistemin gradë-minuta-sekonda si vijon: në gradë (dy shifra), minuta (dy shifra) dhe sekonda (dy shifra) të ndjekura nga N (North=Veri) apo S (South=Jug). Në rastin tonë do të përdoret vetëm germa N sepse vendi ynë ndodhet në pjesën veriore të hemisferit. Në rastet kur vlerat janë me nga një shifër, shtohet nga një “0” përpara, p.sh., *413802N*, që do të thotë se pika e koleksionimit ndodhet në *41°38’02” të pjesës veriore të hemisferit*. Në rastet kur mungojnë të dhënat për *minutat dhe/ose sekondat*, ato zëvendësohen me vija lidhëse, p.sh., *4125--N, ose 39----N*.

15.3 Gjatësia gjeografike e pikës së koleksionimit (DECLONGITUDE).

Informacioni shkruhet në formatin dhjetor të gradëve, me vlera pozitive në lindje të meridianit *Greenwich* dhe me vlera negative në perëndim të meridianit *Greenwich*. Vendi ynë ndodhet në lindje të meridianit *Greenwich*. Prandaj do të kemi shënjen plus; psh: +19.0801, për vlerën *0190801E* dhënë sipas formatit gradë-minuta-sekonda (shiko 15.4).

15.4 Gjatësia gjeografike e pikës së koleksionimit (LONGITUDE).

Informacioni shkruhet në sistemin gradë-minuta-sekonda si vijon: në gradë (dy shifra), minuta (dy shifra) dhe sekonda (dy shifra) të ndjekura nga **E** (East) Lindje (pjesa lindore e perëndimore e botës, e ndarë nga një vijë imagjinare e përfaqësuar nga meridiani *Greenwich*) dhe **W** (West) Perëndim. Në rastin tonë do të përdoret vetëm germa **E** sepse vendi ynë ndodhet në pjesën lindore. Vlerës së gradës i shtohet një “0” përpara; e njëjta gjë veprohet edhe për pjesën në Perëndim, psh: 0192122; ose 0761832E.

15.5 Koordinat të pasigurta/paqarta (COORDUNCERT).

Informacioni jo i saktë i shoqëruar me koordinata në metra. Lihet vlera bosh kur pasaktësia nuk dihet.

15.6 Karakteristika e koordinatave (COORDDATUM).

Informacion mbi karakteristikat gjeografike ose sistemet e referencës sipas të cilit koordinatat jepen në formatin dhjetor (Decimal degree = DD) për gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike. (psh: WGS84, ETRS89, NAD83). Kjo për faktin se GPS përdorin sistemin e të dhënave WGS84.

15.7 Metoda e gjeoreferencës (GEOREFMETH). Jepet informacion mbi metodën e gjeoreferencës së përdorur (Pozicion gjeografik i përcaktuar nga harta, buletine, ose i vlerësuar me programe GIS). Lihet bosh nëse nuk njihet metoda e gjeoreferencës).

16. Lartësia mbi nivelin e detit e pikës së koleksionimit (ELEVATION).

Shënohet lartësia mbi nivelin e detit e pikës së koleksionimit, shprehur në metra, p.sh., 18; 120; 760; 2100, etj. Për këtë deskriptor lejohen edhe vlera negative, nëse pika e koleksionimit ndodhet nën nivelin e detit.

17. Data e koleksionimit të mostrës (COLLDATE).

Për regjistrimin e datës së koleksionimit të mostrës veprohet si në rastin e deskriptorit 12. *Data e pranimit (ACQDATE)*. Në fushë regjistrohet data në të cilën një mostër është koleksionuar. Data regjistrohet sipas formatit *VVVVMMDD (YYYYMMDD)*. Pra, në fillim shënohet viti i plotë (p.sh., 1975), mandej, pa lënë hapësirë nga viti, shënohet muaji me dy shifra dhe data me dy shifra.

Kur mungojnë të dhëna (MM, ose DD) ato duhen shënuar me dy vijëza lidhëse (--),ose me dy zero "00".

18. Kodi i institutit seleksionues (BREDCODE). Shënohet kodi i institutit të dhënë nga FAO. Shërben për të shënuar informacionin e institutit që ka seleksionuar materialin bimor që përfaqësohet nga aksesioni aktual. Nëse si seleksionues është vetë instituti që ruan materialin atëherë BREDCODE duhet të jetë njëloj me **Kodin e institutit (INSTCODE)**.

18.1 Emri i institutit seleksionues (BREDNAME). Shënohet emri i institutit (ose personit) që ka seleksionuar materialin. Ky deskriptor përdoret vetëm kur mungon **Kodi i institutit seleksionues (BREDCODE)**, për shkak së nuk është i vlefshëm në listën e FAO. Kur ka shumë emra, atëherë ato ndahen me pikëpresje, pa hapsirë boshe.

19. Statusi biologjik i aksesionit (SAMPSTAT). Ky deskriptor shërben për të dhënë informacion mbi statusin biologjik të aksesionit. Për të shprehur këtë është hartuar një sistem kodimi në tre nivele të ndryshme. Niveli i parë përfaqësohet nga kodet e përgjithshme të cilët regjistrohen me kodet përkatëse shifrore me **të zezë (bold)**, p.sh., **100; 200; 300; 400;** etj. Por statusi i aksesionit mund të shprehet duke përdorur kodet më specifike që janë kode të nivelit të dytë dhe të tretë, që shkruhen me shkrim të zakonshëm, p.sh., 110; 410; 414; etj. Pra, statusi biologjik i një aksesioni mund të shënohet, p.sh., ose **100** ose 110 apo 120; ose **400** ose 410 apo 414, etj. Në rast se statusi i një aksesioni që vjen në bankën tuaj gjenetike nuk shprehet në asnjë nga kategoritë që janë parashikuar në këta deskriptor, ju mund ta shtoni atë duke përdorur fushën numër **28. REMARKS**.

Kategoritë e statusit biologjik të aksesionit jepen në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, për tu përdorur sipas nevojës.

100 Wild=I egër

110 Natural=Natyrar

120 Semi-natural/wild=Gjysmë natyror/i egër.

130 Semi-natural/soën=Gjysmë natyror/i mbjellë.

200 Weedy=Bar i keq

300 Traditional kultivar/landrace=Kultivar tradicional/ kultivar i fermerit (primitiv)

400 Breeding/research material=Material seleksionimi/ kërkimor

410 Breeder's line=Linjë e seleksionerit

411 Synthetic population=Popullatë sintetike.

- 412 Hybrid=Hibrid
 413 Founder stock/ base population = Stoku (rezerva) i krijuesit/
 popullata bazë
 414 Inbred line (parent of hibrid kultivar) = Linjë inbrede (prindër
 të hibridit)
 415 Segregating population = Popullatë në zbërthim.
 416 Clonal selection = seleksionim klonal.
 420 Genetic stock = Rezervë/ stok gjenetik.
 421 Mutant stock = Rezervë /stock mutant.
 422 Cytogenetic stock = Rezervë /stock Citogjenetik.
 423 Other genetic stocks = Rezerva /stoqe të tjerë gjenetike.
500 Advanced/improved kultivar=Kultivar i avancuar/i përmirësuar.
600 OMGj. (krijuar nga Inxhinieria gjenetike).
999 Other (elaborate in REMARKS field) = Tjetër (përpunohet në
 fushën REMARKS).

20. Të dhëna të prejardhjes (ANCEST). Me këtë deskriptori jepet informacion ose mbi pedigren ose ndonjë informacion tjetër mbi prejardhjen e aksesionit (p.sh., varietetet që janë përdorur si prindër, në rastin e mutantit apo materialit të seleksionimit). P.sh. *Hanna/7*Atlas//Turk/8*Atlas* (Hanna është kryqëzuar për herë të parë me Atlas me 7 herë backcross dhe kryqëzimin e dytë e ka bërë me Turk i cili është kryqëzuar për herë të parë me Atlas me 8 herë backcross); *mutation found in Hanna* (mutant i gjetur tek Hanna); *selection from Irene* (zgjedhur tek Irene); etj.

21. Burimi i koleksionimit/pranimit (COLLSRC). Ky deskriptor shërben për të dhënë informacion mbi burimin e materialit të koleksionuar apo të pranuar në bankën gjenetike. Burimi i koleksionimit/pranimit të aksesionit shprehet nëpërmjet një sistemi kodimi i cili paraqitet në dy nivele të ndryshme. Niveli i parë përfaqësohet nga kodet e përgjithshme të cilët regjistrohen me kodet përkatëse shifrore me *të zezë (bold)*, p.sh., **10; 20; 30; 40**; etj. Por statusi i aksesionit mund të shprehet duke përdorur kodet më specifike që janë kode të nivelit të dytë, që shkruhen me shkrim të zakonshëm, p.sh., 11; 12; 13; etj. Pra, statusi biologjik i aksesionit shënohet, p.sh., ose **10** ose 11 apo 12; ose **20** ose 21 apo 22, etj. Në rast se burimi i koleksionimit/pranimit të aksesionit që vjen në bankën tuaj gjenetike nuk shprehet në asnjë nga kategoritë që janë parashikuar në këta deskriptor, ju mund ta shtoni atë duke përdorur fushën *REMARKS*, që do të trajtohet më vonë (deskriptori 28).

Kategoritë e burimit të koleksionimit të aksesionit jepen në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, për tu përdorur sipas nevojës.

- 10** Wild habitat=Habitat (mjedisi i rritjes) i egër
 - 11 Forest/woodland=Pyll/zonë pyjore
 - 12 Shrubland=Vend me shkurre
 - 13 Grassland=Vend i mbuluar me bar të egër
 - 14 Desert/tundra=Shkretëtirë/tundër (vend shumë i ftohtë dhe pa pemë)
 - 15 Aquatic habitat=Habitat ujqor
- 20** Farm or cultivated habitat=Fermë ose habitat i kultivuar
 - 21 Field=Fushë (arë)
 - 22 Orchard=Pemëtore
 - 23 Backyard, kitchen or home garden (urban, peri-urban or rural)=Oborr pas shtëpisë, kuzhinës apo banesës (urban, afër-urban ose rural)
 - 24 Fallow land=Ugar
 - 25 Pasture=Kullotë
 - 26 Farm store=Depo e fermerit
 - 27 Threshing floor= Lëmë
 - 28 Park=Park (kopsht)
- 30** Market or shop=Treg (pazar) ose dyqan
- 40** Institute, Experimental station, Research organization, Genebank = Institut, Stacion eksperimental, Organizatë kërkimore, Bankë gjenetike.
- 50** Seed company=Kompani farash.
- 60** Weedy, disturbed or ruderal habitat=Habitat bari i keq, habitat i çrregullt ose i ashpër.
 - 61 Roadside=Anë rruge.
 - 62 Field margin=Anë are.
- 99** Other (elaborate in REMARKS field) = Tjetër (përpunohet në fushën REMARKS).

22. Kodi i institutit dhurues (DONORCODE). Shënohet kodi i institutit dhurues sipas listës së *FAO*-s. Si tek deskriptori numër **1. Kodi i institutit.**

22.1 Emri i institutit dhurues (DONORNAME). Shënohet emri i institutit dhurues sipas listës së *FAO*-s (ose personi). Ky deskriptor përdoret nëse nuk njihet Kodi i institutit dhurues (**DONORCODE**), pasi nuk është i vlefshëm në listën e **FAO**.

23. Numri i aksesionit të dhuruesit (DONORNUMB). Shënohet numri identifikues i aksesionit të vendosur nga instituti dhurues, p.sh., *IKB1590*. Ndjek standardin e **(2. Numri i aksesionit (ACCENUMB))**.

24. Identifikues të tjetër (numra) që shoqërojnë aksesionin (OTHERNUMB). Shënohet ndonjë identifikues (numër) tjetër që dihet se ekziston në koleksione të tjerë për atë aksesion. Nëse ka ndonjë rast të tillë, regjistrimi bëhet me sistemin: *INSTCODE:ACCENUMB*, duke i ndarë ato me dy pika (:), pa lënë hapësirë midis tyre. Nëse ai aksesion ka numër tjetër në më shumë se një koleksion, çiftet Kod instituti dhe Numër aksesioni ndahen nga një pikëpresje (;) pa lënë hapësirë midis tyre si: *INSTCODE:ACCENUMB;INSTCODE:ACCENUMB*. Në rastet kur instituti nuk njihet, numri i aksesionit paraprihet nga dy pika (:). Le të japim një shembull *ALB002:IKB254;ALB007;;IKF054*.

25. Vendndodhja e dublikatave shpëtues (DUPLSITE). Shënohet kodi i institutit ku mbahet një dublikatë shpëtues i një aksesioni të caktuar. Për këtë deskriptor përdoren Kodet e Instituteve të *FAO*-s, si në rastin e deskriptorit *1. Kodi i institutit*.

25.1 Emri i institutit që mban dublikatat shpëtuese (DUPLINSTNAME). Shënohet emri i institutit ku mbahen dublikatat shpëtues të një ose disa aksesioneve të të caktuar. Për këtë deskriptor përdoren emërtimet e Instituteve të *FAO*-s.

26. Tipi i ruajtjes së gjermoplazmës (STORAGE). Ky deskriptor shërben për të dhënë informacion mbi tipin e ruajtjes së gjermoplazmës në një bankë gjenetike. Për të paraqitur tipin e ruajtjes së gjermoplazmës është hartuar një sistem kodime me dy nivele, si vijon:

10 Seed collection=Koleksion fare.

11 Short term=Afatshkurtër.

12 Medium term=Afatmesëm.

13 Long term=Afatgjatë.

20 Field collection=Koleksion fushor .

30 In vitro collection (Slow growth)=Koleksion in vitro (Rritje e ngadaltë)

40 Cryopreserved collection=Koleksion i ruajtur në temperatura shumë të ulëta, zakonisht në azot të lëngshëm (-196°C)

50 DNA collection = Koleksione të ADNs.

99 Other (elaborate in REMARKS field)=Tjetër (përpunohet në fushën REMARKS)

Në rastet kur gjermoplazma mbahet në shumë tipe të ndryshme ruajtjeje, ato ndahen nga pikëpresje (;), p.sh.: 10;20, etj.

27. Statusi MLS (MLSSTAT). Statusi i koduar i një aksesioni në lidhje me Sistemin Multilateral (MLS) apo Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi Resurset Gjenetike Bimore për Ushqimin dhe Bujqësinë.

Jep informacion nëse aksesioni është përfshirë në MLS.

0 – Jo, nuk është pjesë e MLS-ës

1 – Po, është pjesë e MLS-ës

Nëse nuk dihet statusi MLS, fusha lihet bosh.

28. Shënime (REMARKS). Përdoret për shënime ose për të përpunuar deskriptorët me vlerat 99 ose 999 (= Other), d.m.th., në fusha të caktuara, tek të cilat mund të gjenden kategori të tjera të papërfshira në deskriptorët e tyre (Fushat që kanë vlerat 99 ose 999 në fund të kategorive të miratuara), mund të shtohen kategori të reja tek fusha REMARKS. Shënimi bëhet duke vendosur përpara emrin e fushës të cilës i referohet ai (shënimi) dhe me dy pika (:). P.sh. nëse kemi një aksesion të dhuruar nga një seleksioner privat, kategori kjo e paparashikuar tek deskriptori *Burimi i koleksionimit/pranimit* veprohet në këtë mënyrë: Tek deskriptori përkatës shënohet kodi **99**, kurse tek deskriptori *REMARKS* shënohet *COLLSRC:Private breeder*. Po kështu, në rast se kemi aksione të riatdhesuar, tek deskriptori përkatës shënohet kodi **99**, kurse tek deskriptori *REMARKS* shënohet *COLLSRC:REPATRIATED*, etj.

29. Adresa në internet e aksesionit (ACCEURL). Lidhja në URL ose me bankën gjenetike që e mban atë aksesion, ose nga një burim tjetër, për të dhëna shtesë mbi aksesionin e dhënë, p.sh., <http://qrgj.org/>

30. Statusi AEGIS (AEGISSTAT). Statusi i koduar i një aksesioni në lidhje me Sistemin Evropian të Integruar të Bankave Gjenetike (AEGIS). Jep informacion nëse aksesioni ruhet për AEGIS.

0 –Jo, nuk është pjesë e AEGIS.

1 –Po, është pjesë e AEGIS.

Nëse nuk dihet statusi AEGS, fusha lihet bosh.

31. Aksesion historik (HISTORIC). Këtu tregohet nëse një aksesion i përdor kohë më parë nuk rihet më në bankën gjenetike. Në këtë rast të dhënat historike ruhen dhe mund të kenë informacion me vlerë.